

**DEPARTEMENT
GESUNDHEIT UND SOZIALES**
Abteilung Gesundheit

07 Maj 2021

FUSHATA E VAKSINIMIT KANTONI AARGAU

Vaksinimi COVID-19

1. Regjistrimi për vaksinën Covid-19

Para se të regjistroheni, lexoni ju lutemi me patjetër plotësisht shpjegimet e mëposhtme.

Personave nën 65 vjeç me sëmundje të mëparshme me rrezikun më të lartë i nevojitet një vërtetim mjekësor gjatë vaksinimit.

Prej datës 7 Maj të gjithë personat duket filluar nga 16 vjeç në kantonin e Aargau do të marrin një datë për kryerjen e vaksinimit. Kush regjistrohet i pari, merr si fillim një datë. Grupet e mëposhtme mbeten të priorizuara:

- Personat mbi 65 vjeç
- Personat me sëmundje të mëparshme me rrezikun më të lartë (detyrim për pajisje me vërtetim)
- Punonjësit në sistemin shëndetësor dhe në sektorin social dhe mjekësor (nevojitet konfirmimi i punëdhënësit)

Grupet e tjera të priorizuara më parë nuk marrin më data të priorizuara vaksinimi. Personat që përfshihen këtu me sëmundje të mëparshme pa rrezikun më të lartë ose pjesëtarët e familjes së personave që janë shumë të rrezikuar.

Nëse banoni jashtë kantonit Aargau, ju nuk mund të vaksinoheni në kantonin e Aargau. Përjashtim bëjnë punonjësit në sektorin e shëndetësisë dhe të sektorit social dhe mjekësor, të cilët punojnë në kantonin e Aargau.

Ato regjistrohen këtu për një datë vaksinimi, pavarësisht nga mosha e tyre ose nga sëmundjet e tjera të mëparshme. Sapo për ju të jetë i disponueshëm një datë vaksinimi, ju merrni një SMS me datën. Nëse ju nuk mund të shkoni në atë datë, ju mund ta anuloni datën dhe të regjistroheni për një datë të re. Për momentin ju nuk mund të zgjidhni ende vetë, se kur mund të vaksinoheni.

Ju nuk mund të zgjidhni se me cilën vaksinë do të vaksinoheni.

Një përmbledhje me linqet për te qendrat e vaksinimit duke përfshirë planet e vendndodhjes gjeni në www.ag.ch/coronavirus-impfung.

1.1 Regjistrimi

Këtu mund të shkoni te faqja e regjistrimit për vaksinën Covid-19.

► [Për te regjistrimi](#)

1.2 Nuk posedoni telefon celular?

Nëse nuk posedoni një telefon celular tuajin, ju mund të kërkonti që t'ju dërgojnë SMS për datën tuaj edhe në telefonin celular të një pjesëtare të familjes, një personi të besueshëm ose një personi që kujdeset për ju.

1.3 Nuk keni akses në internet dhe telefon celular?

Personat pa akses në internet dhe telefon celular do të marrin ndihmë për regjistrimin e datës te farmacitë e Aargau. Për këtë gjë ju nevojitet vetëm një numër telefoni fiks.